



Ne baze të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, e në mbështetje të nenit 14, paragrafi 1, lidhur me paragrafin 3, të Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 10/2019”, e konform nenit 6, pika 3, lidhur me nenin 8 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe neneve 15 dhe 29, pika 2 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë, -----, miratoi këtë:

Projekt-V E N D I M

Neni 1

1.1 JEPET PËLQIMI- për të zhvilluar procedurat e ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër prej 1, (një) deri në 15, (pesëmbëdhjetë) vite të pronës së paluajtshme të Komunës parcela si më poshtë:

1.2 Parcela, kadastrale, me numër **P-72116046-02785-104**, sipas certifikatës Nr.3033-2024, të datës 09.09.2024 me sipërfaqe prej; **39156m²** nga sipërfaqja e përgjithshme prej; **177190m²** vendi i quajtur **“Shiroko”**, zona kadastrale Suharekë, pasurisë shoqërore në emër të Komunës së Suharekës, me destinim sipas vendimit të Kuvendit të Komunës në Suharekë 01-Nr-16-7254 të datës 30.06.2015, është caktuar lokacion për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore.

Neni 2

OBLIGOHET-Drejtoria për shërbime pronësore juridike dhe kadastrë dhe zyra e prokurimit që në bashkëpunim me komisioni për zbatimin procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, afatshkurtër, që të zhvillojë procedurat e ankandit publik, konform dispozitave të Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr. 10/2019” dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË

01-Nr-_____
Më datë_____

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI